

# “KARAKTERISTIKA TË LIGJËRIMIT POLITIK NË SHQIPËRI GJATË ZGJEDHJEVE TË 28 QERSHORIT 2009”.

Aulona Zotaj

## Abstact

Përse politika është larguar nga përmbajtja duke i kushtuar më shumë rëndësi formës? Përse politikanët zgjedhin të përdorin një gjuhë plot metafora e metonimi, ose ligjërimet shtrënguese sic na thotë Paul Chilton? Cili është qëllimi tyre i vërtetë? Përse liberalët e kanë gjithmonë të vështirë të kuptojnë fjalimet e konsevatorëve dhe kontekstin në të cilin ato përdoren? Këtyre dilemave por dhe shumë të tjerave jam munduar që tu jap një përgjigje duke u mbështetur te autorë e specialistë të ndryshëm të ligjërimet politik në botë. Një interes të madh kanë ngjallur tek unë dhe dy autorë të njohur në arenën botërore në këtë fushë që janë Paul Chilton dhe Norman Fairclough. Analiza e diskursit tredimensional i Chiltonit dhe procesi colloquialisation janë shumë me interes sepse me anën e tyre ne mund të hulumtojmë në përsen e kësaj gjuhe dhe ligjërimi të përzgjedhur nga politikanët. Një analizë e hollësishme i është bërë dhe realitetit të ligjërimet politik ne Shqiperi i cili sigurisht është i vonuar në kohë në krahasim me vëndet e tjera evropiane. Karakteristikat e ligjërimet politik të zgjedhjeve të 28 qershorit, dhe situata e ndërlikuar në të cilën gjëndet vendi si pasojë e prodhimit nga politikanët të kësaj “gjuhe të keqe” ashtu sic do ta quante dhe Prof.H.Borici, janë disa nga çështjet që mendoj te trajtoj në kete teme. Me deshirën dhe me shpresën e madhe që politika shqiptare të dale sa me shpejt nga kjo krize komunikimi kam argumentuar disa mënyra se si mund të ndodh kjo. Me e rëndesishmja ndër to është ajo e rolit të palës së tretë e cila pati efekt për zgjidhjen e konfliktit ne Maqedoni ne 2001. Le të shpresojme për më mirë.....